

Rastet me Kancer Gjiri të trajtuara në Institutin Onkologjik në QKUK në periudhën Janar- Dhjetor 2018

Violeta Ukaj<sup>1</sup>, Shemsi Veseli<sup>2</sup>

#### ABSTRAKTI

*Hyrje:* Kanceri i gjirit është sëmundje heterogjene që përfshin një numër karakteristikash dhe sjelljesh klinike të veçanta. Kanceri i gjirit shpesh është i shërueshëm, në veçanti nëse diagnostifikohet në fazat e hershme të paraqitjes. Kanceri gjirit është një patologji malinje mjaftë e shpeshtë tek gratë dhe rrallë herë edhe tek burrat. Qëllimi i këtij studimi është të identifikoj numrin e rasteve me kancer gjiri të trajtuara gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2018 përfshirë të dy gjinitë, dhe të kuptoj grup moshën më të prekur në mënyrë që në të ardhmën të edukojmë personat e prekur për mënyrën e jetesës dhe popullatën lidhur më parandalimin dhe faktorët e rrezikut për paraqitjen e sëmundjes së kancerit të gjirit.

*Metodologjia:* Studimi ishte retrospektiv, te dhënat janë grumbulluar nga protokoli ku janë te evidentuara rastet e reja te prekura nga kanceri i gjirit qe kanë marrë trajtim në Institutin e Onkologjisë në QKUK gjatë vitit 2018, analizimi i të dhënave është bërë me programim kompjuterik SPSS dhe rezultatet janë paraqitur në Exel.

*Rezultatet:* Të gjeturat tregojnë se numri total i rasteve me kancer gjiri përfshirë dy gjinitë dhe gjitha moshat që janë trajtuar ishte 335, numri më i madh i të sëmuarve i takon gjinisë femrore dhe mosha më e prekur është mosha mbi 50 vjeçare.

*Rekomandimet:* Rekomandohet që popullata në përgjithësi të edukohet rreth faktorëve të rrezikut, duke ndryshuar stilin e jetesës, e kjo duhet të arrihet përmes ndërgjegjësimit për ruajtjen e shëndetit. Përfshirja e OJQ-ve dhe politikave shëndetësore janë dominante në parandalimin dhe menaxhimin efektiv të kësaj sëmundje, në edukim të përfshihën të gjitha moshat dhe dy gjinitë e në mënyrë të veçant kategoritë e atyre më të rrezikuar duke përdorur depistim për kancerin e gjirit.

*Fjalët kyqe:* Kanceri i gjirit, incidenca, skreningu, faktorët e rrezikut